

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 01.03.2023*

**Data 1.03.2023**

**Ora 13:05**

**RENDI I DITËS**

*Projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin nr. 2, datë 31.01.2023, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023””.*

**PJESËMARRJA:**

- **KQZ:**
- **Komisioni Rregullator:**

<b>Ilijana NANO</b>	<b>Kryetare</b>	<b>(on-line)</b>
<b>Arens ÇELA</b>	<b>Anëtar</b>	
<b>Dritan ÇAKA</b>	<b>Anëtar</b>	
<b>Helga VUKAJ</b>	<b>Anëtare</b>	
<b>Muharrem ÇAKAJ</b>	<b>Anëtar</b>	
- **Stafi i KQZ-së:**

<b>Y. Merkaj</b>
------------------
- **Parti Politike:** **PL (Fjoraldi Guri)**
- **OJQ:** **KRIIK**

*Znj. I. Nano:* Mirëdita! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme, në orën 13:00. Për shkak se unë nuk jam e pranishme në sallë, po e ndjek mbledhjen on-line, do t'i kërkoja zotit Muharrem Çakaj, anëtar i Komisionit Rregullator, të drejtonte mbledhjen, për të siguruar mbarëvajtjen e saj dhe për të shmangur çdo problematikë teknike që mund të shfaqet. Zoti Çakaj, faleminderit!

1

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 01.03.2023**

**Z. M. Çakaj:** Po faleminderit zonja Kryetare! Atëherë, referuar rregullores që kemi miratuar së bashku me vendimin nr.1 të vitit 2020, me delegimin që më bëri Kryetaria e Komisionit Rregullator, unë po vijoj zhvillimin e mbledhjes. Pra, paraprakisht e deklaroj mbledhjen e hapur dhe verifikojmë prezencën e pjesëmarrësve në mbledhje. Konstatohet se në mbledhje marrin pjesë të katër anëtarët dhe Kryetaria e Komisionit Rregullator. Katër anëtarët e Komisionit Rregullator marrin pjesë fizikisht në mbledhje dhe Kryetaria e Komisionit rregullator merr pjesë on-line.

Në rendin e ditës për mbledhjen e sotme është paraqitur një projektakt me titull “Për disa ndryshime në vendimin nr. 2, datë 31.01.2023, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023””.

Gjithashtu, merr pjesë një përfaqësues i subjektit, partisë politike, në mos gabo, Partia e Lirisë. Kemi të ftuar dhe një përfaqësues, besoj i organizatës KRIIK. Ftoj Sekretarin e Përgjithshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të relatojë projektaktin në mënyrë të përmbledhur.

**Z. Y. Merkaç:** Faleminderit! Me vendimin nr. 2, datë 31.01.2023, Komisioni Rregullator ka miratuar disa karakteristika teknike të fletëve të votimit që do të përdoren për zgjedhjet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Neni 97, pika 2 e Kodit Zgjedhor përcakton se, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore zgjedhësi voton me dy fleta votimi me formë të njëjtë dhe me ngjyra të ndryshme, një për kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore dhe një për këshillin e bashkisë. Pika 3/1 e këtij neni përcakton se ngjyra e fletës në zgjedhjet e qeverisjes vendore, është e njëjtë në të dyja anët e saj. Sikundër është argumentuar edhe në relacionin

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 01.03.2023**

shpjegues të vendimit nr. 2/2023, propozimi për kodet e ngjyrave u bazua në përvojën e deritanishme të ndjekur edhe në zgjedhjet e mëparshme, të viteve 2015 dhe 2019. Administrata e KQZ-së menjëherë pas miratimit të vendimit u angazhua në lëvrimin e programeve të edukimit për zgjedhësit me simulimin e procesit të votimit me modelet e fletëve të votimit të printuara sipas kodeve të miratuara nga Komisioni Rregullator. Në këto sesione të edukimit të zgjedhësve që i përkasin grupeve të ndryshme, u përcoll konsiderata për të rivlerësuar ngjyrat e fletës së votimit. U konstatua se ngjyrat dalin me nuancë të fortë dhe nuk lejojnë plotësisht evidentimin e përmbajtjes së fletëve të votimit. Emrat e kandidatëve dhe subjekteve zgjedhore duhet të duken qartë dhe të krijojnë lehtësi për t'u lexuar nga ana e të gjithë zgjedhësve, varësisht moshës së tyre. Evidentimi qartë i emrave të kandidatëve dhe subjekteve zgjedhore që garojnë ka përparësi për procesin e votimit. Në këto kushte, u konkludua që t'i propozohet Komisionit Rregullator, ndryshimi i kodeve të ngjyrave për të dyja fletët e votimit, konkretisht si më poshtë vijon:

Kodi i ngjyrës së fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie ka qenë Panton 366 C, propozohet të ndryshohet: PANTONE 7401 U (ngjyrë e artë).

Kodi i ngjyrës së fletës së votimit për kandidatët për anëtarët e këshillit bashkiak është miratuar Panton 108 C , ngjyrë e verdhë e fortë, propozohet të ndryshohet: PANTONE 179 – 2 U , që është ngjyrë gri.

Propozimet e tjera për ndryshimin e orientimit të fletës së votimit, Komisioneri e tërheq propozimin nga akti. Për sa më sipër keni për shqyrtim dhe miratim aktin e mësipërm “Për disa ndryshime në vendimin nr. 2, datë 31.01.2023, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023””. Faleminderit!

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 01.03.2023**

**Z. M. Çakaj:** Po, faleminderit zoti Sekretar i Përgjithshëm. Paraprakisht para se të vijojmë me diskutimet për rendin e ditës, ftoj pjesëmarrësit në mbledhje, nëse kanë çështje jashtë rendit të ditës, mund të paraqesin kërkesën e tyre. Anëtarët e Komisionit Rregullator, ose përfaqësuesit? Konstatohet se nuk ka çështje jashtë rendit të ditës. Atëherë vijojmë paraprakisht me miratimin në parim të projektaktit të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Kush është dakord me projektvendimin e paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve “Për disa ndryshime në vendimin nr. 2, datë 31.01.2023, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023””?

**Kush është dakord në parim?**

**Verifikohet se dhe Kryetaria e Komisionit Rregullator ka votuar pro.**

**Pro:** 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, zgj.Vukaj, z. Çakaj)

**Kundër:** S’ka.

*Me 5 vota pro miratohet në parim ky projektakt.*

Kalojmë në diskutimin dhe miratimin nën nën të këtij projektakti. Atëherë, Pika 1. Në lidhjen nr. 1 dhe nr. 2 të vendimit nr. 2, datë 31.01.2023 të Komisionit Rregullator bëhen këto ndryshime:

Në lidhjen nr. 1, nënpika “i”, kodi i ngjyrës së fletës së votimit ndryshohet dhe bëhet “ngjyra e fletës së votimit”, kodi i ngjyrës PANTONE 7401 U.

Për saktësi dhe për transparencë... po!

**Zgj. H. Vukaj:** Do të doja të dija nga ju Sekretar i Përgjithshëm dhe pas testimit që keni bërë të ekspozonit ngjyrën përkatëse të printuar në letër.

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 01.03.2023**

**Z. Y. Merkaj:** Po, i kemi përgatitur të dy modelet, por janë printuar në dy printera të ndryshëm që nuk janë profesionalë dhe ngjyrat dalin pak më ndryshe. (tregon) Kjo është fleta e votimit që propozohet për kandidatin për kryetar bashkie, ose kjo që është me emra, ose kjo tjetra që është fleta e votimit pa emra që ka dhe kodin 7401 U. Ndërsa për kandidatët e këshillit bashkiak është propozuar fleta e votimit (tregon) që ka këtë ngjyrë, del gri sipas kodit të parashikuar dhe përcaktuar nga dizajneri.

**Z. M. Çakaj:** Po, këto dy mostra që ju na treguat janë modelet të cilat i bashkëngjiten vendimit? Modeli i fletës së votimit (ngjyra) për kandidatët për kryetarë bashkie dhe modeli për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak?

**Z. Y. Merkaj:** Po!

**Z. M. Çakaj:** Faleminderit! Jeni e qartë zonja Vukaj?

**Znj. H. Vukaj:** Po!

**Z. M. Çakaj:** Atëherë, duke qenë se Sekretari i Përgjithshëm nënpikën “ii” e tërhoqi, me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nga rendi i ditës, kjo nënpikë nuk do të shqyrtohet dhe nuk do të diskutohet, sigurisht dhe nuk do të miratohet. Pas germës “a”, të ndryshohet të bëhet germa “b”, besoj është një lapsus i administratës. Të hiqen fjalët “... Orientimi i fletës së votimit: Peizazh (landscape) ...”, sepse është hequr nga rendi i ditës. Germa “a” do të bëhet germa “b”. Në lidhjen nr. 2, vijon nënpika “i” Kodi i ngjyrës së fletës së votimit ndryshohet dhe bëhet “Ngjyra e fletës



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 01.03.2023**

së votimit: kodi i ngjyrës: PANTONE 179 – 2 U”. Bëhet fjalë për ngjyrën e fletës së votimit për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak.

Edhe këtu hiqet nënpika “ii” Fjalët “... Orientimi i fletës së votimit: Portret ...” hiqet, sepse nuk shtrohet çështja për miratim.

***Kush është dakord me këtë propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)***

***Kundër: S’ka.***

*Me 5 vota pro miratohet ky ndryshim.*

Pika “b” do të bëhet në rastin konkret pika 2 dhe do të vijojë numërtimi: pika 3, pika 4.

Pika 2. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)***

***Kundër: S’ka.***

*Me 5 vota pro miratohet.*

Pika “c” bëhet:

Pika 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)***

***Kundër: S’ka.***

*Me 5 vota pro miratohet.*

Pika “d”, bëhet :

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 01.03.2023**

Pika 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

***Kush është dakord me këtë pikë?***

***Pro:*** 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, zgj.Vukaj, z. Çakaj)

***Kundër:*** S'ka.

*Me 5 vota pro miratohet.*

Kalojmë në votimin në tërësi të këtij akti.

***Kush është dakord me projektaktin për miratimin në tërësi me ndryshimet e propozuara në këtë mbledhje?***

***Pro:*** 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, zgj.Vukaj, z. Çakaj)

***Kundër:*** S'ka.Me 5 vota pro miratohet.

Duke qenë se siç e thamë dhe më parë, nuk ka çështje dhe diskutime jashtë rendit të ditës, e deklarojmë mbledhjen të mbyllur.

**Vendimi nr. 9**

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**

